

“VRANINA” SH.P.K.

Gllaviçicë, komuna Pejë



**RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR ZGJERIMIN E ZONËS
PËR EKSPLOATIMIN E INERTEVE NGA KOMPANAI “VRANINA” SH.P.K.,
Gllaviçicë, Komuna Pejë**

Pejë, Dhjetorë 2025

**RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR ZGJERIMIN E ZONËS
PËR EKSPLOATIMIN E INERTEVE NGA KOMPANIA “VRANINA” SH.P.K.,
PEJË, NË GASTRAT KADASTRALE P-71611018-00204-1, 71611018-00203-4,
71611018-00203-3, 71611018-00203-2, ZONA KADASTRALE GLLAVIÇICË,
KOMUNA E PEJËS**

	Emri	Hartueset e Raportit të VNM-së
Aplikuesi	Ukë Nimani	Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Investitori:	“VRANINA” SH.P.K. Pronar: Valon Nimani Person i Autorizuar: Ukë Nimani,	
Adresa:	Pejë	Glllogoc
Lokacioni i Zonës	Gllaviçicë	
Tel:	+383 49 125 395	+383 49 588 634
Email:	vrantina@hotmail.com	Blerinabajraktari1@gmail.com

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Përmbajtja

1.	HYRJE.....	5
1.1.	Përshkrimi i Projektit.....	5
1.2	Vendndodhja e Projektit.....	6
1.3	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit.....	8
1.4	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit.....	8
1.5	Lënda e pare dhe lënda ndihmëse	10
1.6	Përshkrimi detal i procesit teknologjik	10
	□ Pastrimi i Terrenit.....	11
	□ Nxjerrja	11
	□ Monitorimi.....	11
2.	komiza ligjore për hartimin e raportit të vnm- Së.....	12
3.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR SHFRYTËZIMIN E TOKËS PËR NXJERRJEN E RËRËS DHE ZHAVORRIT.....	13
	2. Afërsia me Burimet e Ujit - Lokacioni ndodhet në largësi 310m largë lumit Lumbardhi i Pjës 13	
	4. Ndikimi Ambientalë i Ulët - Zgjedhja e lokacionit duhet të ndikim minimal në biodiversitetin dhe ekosistemet lokale.	14
	4. Lehtësimi i Procesit të Nxjerrjes - Afërsia e lokacionin me separacionin lehtëson operacionet e nxjerrjes, duke e bërë procesin më të shpejtë dhe efikas. Materialet mund të nxirren dhe transportohen më shpejt në proceset e mëtejshme.....	14
4.	gjendja aktuale e mjedisit.....	15
4.1	Flora dhe Fauna	15
4.2	Klima dhe Temperatura.....	16
4.3	Karakteristikat Hidrografike.....	17
4.4	Lagështia Relative e Ajrit.....	19
4.5	Vrantësimi dhe diellosja.....	19
4.6	Të reshurat.....	19
4.7	Era.....	19
5.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	20
5.1	Ndikimet në ajër.....	20
5.2	Ndikimet në tokë	21
5.3	Ndikimet në ujë.....	21
5.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	22
5.5	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	22
5.6	Ndikimet nga zhurma.....	23
5.8	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	23

6.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	24
7.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE.....	24
8.	PËRSHKRIMI I MASAVE	26
8.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....	26
8.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë.....	26
8.3	Masa për Zvogëlimin e Ndikimeve në Tokë.....	27
8.4	Masat për mbrojtje nga zhurma.....	27
8.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	28
8.6	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë.....	28
8.7	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	29
9.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE.....	30
10.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	30
11.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	31
12.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMË TABELARE.....	32
13.	LITERATURA E PËRDORUR.....	33

LISTA E FIGURAVE

Figura 1.	Zona e shfrytëzimit të inerteve nga kompania "VRANINA" Sh.p.k.....	6
Figura 2.	Shtrirja Hapësinore e Lokacionit të Zonës së shfrytëzimit nga "VRANINA" Sh.p.k.	6
Figura 3.	Distanca e Lokacionit të Zonës së Shfrytëzimit me Komunën e Pejës.....	7
Figura 4.	Distanca me objektet e banimit.....	7
Figura 5.	Distanca me industri me veprimtari tjera	8
Figura 6.	Të Dhënat Klimatologjike për Rajonin e Pejës.....	17
Figura 7.	Rrjeti Hidrografik i komunës se Pejës	18

LISTA E TABELAVE

Tabel 1.	Tabela e vlerave të lejuara të zhurmës.....	23
----------	---	----

1. HYRJE

Bazuar në nenin 11 dhe Shtojcën 4 të Ligjit nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe në përmbushjen e kushteve përkatëse ndërtimore dhe mjedisore, kompania **“VRANINA” SH.P.K.** ka filluar përgatitjen dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për zgjerimin e zonës së eksploatimit të inerteve. Kompania **“VRANINA” SH.P.K.** është një ndërmarrje e angazhuar në eksploatimin dhe shfrytëzimin e materialeve inerte, për nevojat e sektorit të ndërtimit dhe infrastrukturës. Aktiviteti zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet mjedisore, duke synuar shfrytëzim racional dhe të kontrolluar të burimeve natyrore. Proceset teknologjike të planifikuara janë të orientuara drejt minimizimit të ndikimeve negative në mjedis, përmes zbatimit të praktikave të mira operative dhe masave parandaluese. Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është hartuar me qëllim të identifikimit dhe vlerësimit të ndikimeve potenciale që mund të paraqiten gjatë fazës së zgjerimit dhe vazhdimit të aktivitetit të eksploatimit, si dhe përcaktimit të masave konkrete për parandalimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e këtyre ndikimeve. Raporti gjithashtu trajton aspektet mjedisore gjatë zhvillimit të aktivitetit, funksionimit të plotë të zonës së eksploatimit, si dhe masat rehabilituese pas përfundimit të shfrytëzimit. Zona e planifikuar për eksploatimin e inerteve ndodhet në Zonën Kadastrale **Gllaviçicë**, Komuna e Pejës, në parcelat kadastrale nr. **P-71611018-00204-1, P-71611018-00203-4, P-71611018-00203-3, P-71611018-00203-1, P-71611018-00203-2** me një sipërfaqe totale prej **14245m²**. Hartimi i këtij raporti synon të sigurojë që zgjerimi i aktivitetit të realizohet në mënyrë të kontrolluar, të qëndrueshme dhe në harmoni me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

1.1. Përshkrimi i Projektit

Projekti i zgjerimit të zonës për eksploatimin e inerteve nga kompania **“VRANINA” SH.P.K.** ka për qëllim zhvillimin e një aktiviteti të qëndrueshëm për nxjerrjen e inerteve, në funksion të furnizimit të tregut të ndërtimit dhe infrastrukturës me materiale cilësore. Projekti është planifikuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe standardet mjedisore, duke marrë në konsideratë mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin racional të burimeve natyrore. Zona e eksploatimit është përcaktuar në bazë të vlerësimeve gjeologjike dhe mjedisore, të cilat konfirmojnë ekzistencën e depozitave të përshtatshme të inerteve si nga aspekti sasior ashtu edhe cilësor. Gjatë planifikimit të projektit janë analizuar ndikimet e mundshme në mjedis dhe janë paraparë masa konkrete për parandalimin dhe zvogëlimin e tyre, në mënyrë që aktiviteti të mos shkaktojë dëmtime të pakthyeshme në ekosistem.



Figura 1. Zona e shfrytëzimit të inerteve nga kompania "VRANINA" Sh.p.k.

Procesi i nxjerrjes së inerteve do të realizohet me përdorimin e makinerive dhe pajisjeve bashkëkohore, duke synuar efikasitetet të lartë operacional dhe ndërhyrje minimale në terren. Aktivitetet e eksplotimit do të zhvillohen në përputhje me kushtet e licencimit, si dhe me masat mbrojtëse për tokën, ajrin, ujërat dhe biodiversitetin përreth zonës së projektit. Materiali i nxjerrë, përkatësisht rëra dhe zhavorri, do të transportohet për përpunim të mëtejshëm në impiantin e separimit, i cili ndodhet në një parcelë tjetër të veçantë. Ky organizim siguron që proceset e përpunimit të mos ngarkojnë shtesë zonën e eksplotimit dhe të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar, në përputhje me standardet teknike dhe mjedisore.

1.2 Vendndodhja e Projektit

Zgjerimi i Zonës së Eksplotimit të Inerteve gjendet në parcelat me numër P-71611018-00204-1, P-71611018-00203-4, P-71611018-00203-3, P-71611018-00203-1, P-71611018-00203-2 Zona kadastrale Gllaviçicë Komuna e Pejës.




Figura 2. Shtrirja Hapësinore e Lokacionit të Zonës së shfrytëzimit nga "VRANINA" Sh.p.k.

Zona e projektit ndodhet në një distancë prej rreth 12.8 km nga qendra urbane e qytetit të Pejës, çka e pozicionon aktivitetin e eksploatimit të inerteve jashtë ndikimit të drejtpërdrejtë të zonave të dendura të banimit dhe funksioneve urbane.




Figura 3. Distanca e Lokacionit të Zonës së Shfrytëzimit me Komunën e Pejës

Në afërsi të lokacionit të zonës së shfrytëzimit për nxjerrjen e inerteve nga kompania “VRANINA” Sh.p.k. nuk ka shtëpi afër, shtëpia më afër është në distancë prej 200 m .




Figura 4. Distanca me objektet e banimit

Afër kësaj zonë ka edhe industri tjera me këtë veprimtari, ku me e afërta është ne distance prej 91.5 m , ndërsa largësia nga rrjedhja e lumit është mbi 310 m.




Figura 5. Distanca me industri me veprimtari tjera

1.3 Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Për shfrytëzimin e materialeve inerte, kompania "VRANINA" SH.P.K. do të përdorë një sërë makinerish dhe pajisjesh të specializuara për të siguruar një operacion efikas dhe të qëndrueshëm. Disa nga makineritë kryesore që do të përdoren janë:

- ✚ Ekskavatorët - janë makineritë kryesore për nxjerrjen e materialeve inerte. Ata përdoren për të gërmuar dhe hequr materialin nga zona e shfrytëzimit.
- ✚ Ngarkuesit - përdoren për të mbledhur materialin inertë të nxjerrë dhe për t'i transferuar ato në makineri të tjera për përpunim apo transport.
- ✚ Buldozerët - përdoren për të niveluar dhe përgatitur terrenin në zonën e shfrytëzimit.
- ✚ Kamionët për Transport - Kamionët me kapacitete të mëdha përdoren për të transportuar materialet inerte nga zona e shfrytëzimit deri në destinacionet e përpunimit ose përfundimtare.
- ✚ Grejderët - Përdoren për të krijuar sipërfaqe të sheshta dhe për të mbajtur rrugët brenda zonës së shfrytëzimit

1.4 Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit të zonës së eksploatimit të materialeve inerte nga kompania "VRANINA" SH.P.K. përfshin aktivitetet kryesore të nxjerrjes dhe shpërndarjes së materialeve. Kjo fazë është e ndarë në disa hapa thelbësorë që synojnë maksimizimin e

eficiencës së procesit, minimizimin e ndikimit në mjedis dhe sigurimin e cilësisë së lartë të produkteve. Veçoritë kryesore përfshijnë:

1. **Përgatitja e Zonës së Punës:** Faza operative fillon me përgatitjen e zonës për nxjerrje, duke përfshirë pastrimin dhe nivelimin e tokës, krijimin e rrugëve të qasshme për makineritë dhe sigurimin e hapësirave për grumbullimin e materialeve. Një zonë mirë e organizuar dhe e përgatitur siguron operime të sigurt dhe të qëndrueshme.
2. **Nxjerrja e Materialeve:** Procesi i nxjerrjes së materialeve inerte realizohet me makineri të specializuara si ekskavatorët dhe ngarkuesit frontalë. Nxjerrja kryhet sipas një plani të miratuar, duke përfshirë një monitorim të vazhdueshëm të sasisë dhe cilësisë së materialeve që nxirren. Përpunimi efikas siguron që materiali të përmbushë standardet e kërkuara për ndërtim, beton, asfalt, dhe përdorime të tjera infrastrukturore.
3. **Transporti dhe Shpërndarja:** Pas nxjerrjes së materialeve inerte ngarkohen në kamionë të mëdhenj për transport në destinacionin e seperuasit për përpunim. Logjistika e mirë organizuar dhe rrugët e qasshme sigurojnë që transporti të kryhet në mënyrë efikase dhe të sigurt.
4. **Menaxhimi i Mbetjeve dhe Rigjenerimi i Zonës:** pas nxjerrjes është një veçori kyçe. Pas përfundimit të operacioneve në një zonë të caktuar, toka do të rehabilitohet duke u rikthyer në gjendjen e saj natyrore ose duke u adaptuar për përdorime të tjera, në përputhje me planet mjedisore.
5. **Monitorimi i Mjedisit dhe Masat për Zbutjen e Ndikimit:** Gjatë gjithë fazës operative, bëhet monitorimi i ndikimit në mjedis, përfshirë ndikimin në burimet ujore, cilësinë e ajrit dhe tokës, si dhe në biodiversitetin lokal. Janë vendosur masa për të zbutur këto ndikime, si përdorimi i barrierave për pluhurin, minimizimi i zhurmës, dhe menaxhimi i ujërave të rrjedhshme.
Monitorimi i vazhdueshëm ndihmon në ruajtjen e një bilanci midis operacioneve ekonomike dhe ruajtjes së mjedisit.
6. **Siguria në Vendin e Punës:** Siguria e punëtorëve dhe e makinerive është prioritet gjatë gjithë fazës operative. Janë vendosur protokolle të rrepta sigurie, përfshirë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, trajnime për punëtorët dhe monitorimi i rrezikut gjatë gjithë kohës.
7. **Përfitimet Sociale dhe Ekonomike:** Faza operative sjell përfitime të rëndësishme për komunitetin lokal, përfshirë krijimin e vendeve të reja të punës dhe stimulimin e zhvillimit ekonomik të zonës. Rritja e aktivitetit industrial do të kontribuojë në zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve ekonomike.

Në përmbledhje, faza operative e projektit është e strukturuar për të arritur një nivel të qëndrueshëm të funksionimit operacional, mbrojtjes së mjedisit dhe krijimit të përfitimeve afatgjate për komunitetin dhe ekonominë lokale.

1.5 Lënda e pare dhe lënda ndihmëse

Lendet e para janë:

- Materialët Inerte

Lende ndihmëse janë:

- Nafta , për funksionimin e makinerisë

1.6 Përshkrimi detal i procesit teknologjik

Procesi i punës për eksploatinimin e inerteve(për nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit) përfshin disa etapa kryesore ato janë:

➤ Hulumtimi Gjeologjik

Hulumtimi Gjeologjik bëhet me qëllime që të identifikohen dhe vlerësohen burimet e materialeve inerte. Metodat që përdoren për hulumtime gjeologjike janë:

- **Analiza Gjeologjike:** Studimi i hartave gjeologjike për të përcaktuar formacionet gjeologjike që përmbajnë materiale inerte.
- **Marrja e Mostrave:** Kryerja e mostrave nga toka dhe analiza e tyre në laboratorë për të përcaktuar përmbajtjen minerale dhe granulën. Kjo ndihmon në vlerësimin e cilësisë së materialeve.
- **Gjeofizika:** Përdorimi i teknikave gjeofizike për të identifikuar struktura nën sipërfaqe dhe për të vlerësuar burimet e mundshme.
- **Studimi i Mjedisit:** Vlerësimi i ndikimeve mbi ekosistemet lokale dhe biodiversitetin, duke përfshirë habitatet e faunës dhe florës.

➤ Planifikimi

Planifikimi bëhet me qëllime që të krijohet një strategji e qartë për shfrytëzimin e burimeve.

Planifikimi përbëhet nga disa pika dhe ato janë:

- **Zonat e Nxjerrjes:** Identifikimi i zonave të përshtatshme për nxjerrje në përputhje me ligjet lokale dhe rregulloret mjedisore.
- **Studimi i Rrezikshmërisë:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme (p.sh., ndotja e ujërave, ndryshimet klimatike) dhe zhvillimi i masave për t'i minimizuar ato.
- **Metodat e Nxjerrjes:** Zgjedhja e metodave më efikase dhe të qëndrueshme për nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit (nxjerrje sipërfaqësore, shfrytëzimi i lumenjve, etj.).
- **Planifikimi për Rikuperimin:** Krijimi i një plani për restaurimin e territorit pas përfundimit të shfrytëzimit, për të siguruar rikthimin në një gjendje natyrale.

➤ Pastrimi i Terrenit

Pastrimi i Terrenit bëhet me qëllim që të përgatitet zona për nxjerrje dhe të krijohen kushte të sigurta për punë. Hapat e pastrimit të terrenit janë:

- **Heqja e Vegjetacionit:** Kjo bëhet zakonisht me përdorimin e buldozerëve, në mënyrë që të eliminohet çdo pengesë.
- **Heqja e Mbeturinave:** Pastrimi i zonës nga ndotësit dhe mbeturinat, që mund të ndikojnë në procesin e nxjerrjes.
- **Vlerësimi i Tokës:** Përcaktimi i nevojave për përmirësimin e strukturës së tokës, si ajrosja ose shtimi i lëndëve organike.

➤ Nxjerrja

Materialet inerte nxirret në mënyrë efikase, për nxjerrjen e materialeve inerte përdoret ekskavatorë për të hequr materialin nga sipërfaqja, kjo përfshin ndarjen e materialeve inerte nga toka.

➤ Monitorimi

Monitorimi bëhet me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me rregulloret dhe të monitorohet ndikimi mjedisor. Aktivitetet e monitorimit janë:

- **Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore:** Monitorimi i cilësisë së ujërave, ajrit dhe tokës për të siguruar që aktivitetet nuk po dëmtojnë mjedisin.
- **Raportimi dhe Rregullimi:** Mbajtja e regjistrave dhe raporteve për aktivitetet e shfrytëzimit dhe ndikimet e mundshme, duke bërë rregullime të nevojshme në proceset e shfrytëzimit.
- **Konsultimi me Autoritetet:** Bashkëpunimi me autoritetet lokale për të siguruar që të gjitha aktivitetet përputhen me ligjet dhe standardet në fuqi.

2. KORNIZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-SË

Bazuar në karakteristikat e zgjerimit të zonë për eksploatimin e materialeve inerte, ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar. Shtojca 2 e këtij ligji, nën paragrafi 2:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 05/L-025
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

3. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME PËR SHFRYTËZIMIN E TOKËS PËR NXJERRJEN E RËRËS DHE ZHAVORRIT.

Disa nga alternativat të arsyeshme për zgjedhjen e lokacionit për shfrytëzimin e tokës për eksploatimin e materialeve inerte janë:

1. **Zonat Gjeologjike të Përshtatshme** – bëhet që kanë formacione gjeologjike të përshtatshme, ku materialet inerte janë të pranishëm në sasi të mjaftueshme. Materialet me cilësi të lartë reduktojnë nevojën për përpunim dhe rrisin efikasitetin ekonomik.

Avantazhet:

- **Materiale Cilësore:** Rrjedh nga përmbajtja e lartë e materialeve inerte që ul nevojën për përpunim.
- **Qëndrueshmëri:** Burimet e disponueshme sigurojnë furnizim të vazhdueshëm.

Disavantazhet:

- **Rreziqet Gjeologjike:** Ndarjet apo lëvizjet e tokës mund të ndikojnë në stabilitetin e operacioneve.
- **Zbulimi i Papritur:** Mund të ketë sasi të pakta të materialeve cilësore në zonat e zgjedhura.

2. **Afërsia me Burimet e Ujit** - Lokacioni ndodhet në largësi 310m largë lumit Lumbardhi i Pejës

Avantazhet:

- **Lehtësim i Procesit:** Rrit efikasitetin e operacioneve që kërkojnë ujë.
- **Menaxhimi i Ujit:** Lehtëson përdorimin dhe ruajtjen e burimeve të ujit.

Disavantazhet:

- **Rreziku i Ndotjes:** Përdorimi i ujit mund të rrezikojë burimet lokale nëse nuk menaxhohet mirë.
- **Konkurrenca për Ujin:** Mund të shkaktojë tensione me komunitetet lokale për përdorimin e ujit.

3. **Prania e Infrastrukturës-** Lokacioni duhet të ketë qasje të mire në rrugë dhe në infrastrukturë transporti. Infrastruktura e zhvilluar lehtëson transportin dhe rrit efikasitetin e operacioneve.

Avantazhet:

- **Transport i Lehtë:** Rrit qasjen në rrugë kryesore dhe ul kostot e transportit.
- **Efikasitet Operacional:** Lehtëson logjistikën dhe menaxhimin e operacioneve.

Disavantazhet:

- **Kostot e Mirëmbajtjes:** Infrastrukturat e zhvilluar kërkojnë investime të vazhdueshme për mirëmbajtje.
- **Ndikimi në Ambient:** Zhvillimi i infrastrukturës mund të ketë ndikime negative në mjedis.

4. Ndikimi Mjedisor i Ulët- Zgjedhja e lokacionit duhet të ndikim minimal në biodiversitetin dhe ekosistemet lokale.

Avantazhet:

- **Ruajtja e Biodiversitetit:** Minimizimi i ndikimeve negative mbi ekosistemet.
- **Përputhshmëria me Rregulloret:** Lehtëson plotësimin e kërkesave mjedisore.

Disavantazhet:

- **Vlerësimi i Pasigurt:** Ndikimet mjedisore mund të jenë të paparashikueshme dhe të vështira për t'u vlerësuar.
- **Kosto për Masat Mbrojtëse:** Mund të kërkojë investime shtesë për ruajtjen e mjedisit.

4. Lehtësimi i Procesit të Nxjerrjes - Afërsia e lokacionin me separacionin lehtëson operacionet e nxjerrjes, duke e bërë procesin më të shpejtë dhe efikas. Materialet mund të nxirren dhe transportohen më shpejt në proceset e mëtejshme.

Avantazhet:

- **Efikasitet i Lartë:** Proceset e nxjerrjes janë më të shpejta dhe më të efektshme.
- **Menaxhim më i Mirë:** Mund të përmirësojë menaxhimin e zinxhirëve të furnizimit.

Disavantazhet:

- **Varësia nga Separacioni:** Ndryshimet në operacionet e separacionit mund të ndikojnë në procesin e nxjerrjes.
- **Rreziku i Konkurrencës:** Afërsia me një separacion mund të krijojë konkurrencë për burime.

Këto avantazhe dhe disavantazhe ndihmojnë në vlerësimin e zgjedhjes së lokacionit për nxjerrjen e rërës dhe zhavorrit dhe në identifikimin e aspekteve që duhet të menaxhohen me kujdes.

4. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Gjendja e mjedisit në komunën e Pejës nuk është e mirë. Degradimi i tij është rezultat i ndërtimeve të pakontrolluara në zonat e mbrojtura të natyrës ashtu edhe jashtë tyre, infrastrukturës jo adekuate, shtimit të numrit të automjeteve dhe importimit të mjeteve motorike të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lart të sulfurit), deponimi i joadekuat i tyre, ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, akumulimit të plehrave urbane si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesës së riciklimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Për më tepër, degradimi ndodhë edhe nga mihjet sipërfaqësore dhe eksploatimi i zhavorrit nga një numër i konsideruar i kompanive. Gjithashtu edhe sektori i transportit është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit dhe në cilësinë e përbërësve të tij (ajrin, ujin dhe tokën). Ai po ashtu ndikon edhe në fragmentimin dhe degradimin e habitateve, ndryshimin e peizazhit, destinimin e shfrytëzimit të tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësore, ajrit dhe dheut dhe si pasojë shkakton dëmtim të resurseve natyror dhe humbje të tokës bujqësore.

4.1 Flora dhe Fauna

Gjendja e florës dhe faunës nuk është e kënaqshme, shkaktarë të kësaj gjendje janë: gjuetia e paligjshme dhe pa kriter, përndjekja dhe kapja e kafshëve me qëllim tregtie, shqetësimi i vazhdueshëm nga ana e njeriut, peshkimi i paligjshëm, prerja, djegia dhe dëmtimi i pyjeve, shkatërrimi i habitateve natyrore, ndikimi i urbanizmit, transportit dhe turizmit, etj. Zhvillimi veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë, siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, prerja e pyjeve, gurthyesit etj., shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës. Ky shfrytëzim i natyrës dhe i vlerave të saja ka atakuar ekosistemet dhe diversitetin biologjik në masë të konsiderueshme.

Biodiversiteti - Komuna e Pejës, shquhet për shumëllojshmëri biologjike dhe të peizazhit. Zona e Bjeshkëve të Nemuna me relievin e thyer, burimet, ujëvarat dhe shpellat, strehon një shumëllojshmëri të habitateve dhe vegjetacionit, duke përfshirë specie endemike, sub-endemike dhe relikte të bimëve.

Krahas me pyjet e ahut dhe të lisit, Bjeshkët e Nemuna janë të pasura me pyje të gështenjës dhe pishave me karakter relikto dhe endemik - munika (*Pinus Leucodermis*), molika (*Pinus Peace*), pisha e bardhë dhe e zezë (*Pinus silvestris et nigra*), etj. Në Majen e Rusolisë rritet bima luleylli (*Lentopodium alpinum*), kurse në Gubavc forzitia (*Forsytia europea*).

Edhe fauna është jashtëzakonisht e pasur e përfaqësuar nga: rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonj bardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*), etj. Lumenjtë janë të pasur me peshq veçanërisht me troftë. Gjithashtu janë prezentë edhe shumë lloje të ujëtokësorëve, reptilëve dhe zvarranikëve. Dallohen breshka e pyllit dhe e kënetave, bretkosat, hardhucat dhe gjarpërinjtë. Në Bjeshkët e Nemuna jetojnë edhe 129 lloje fluturash nga rendi *Lepidoptera* që e bëjnë rajonin ndër më të pasurit në Evropë për çka është identifikuar edhe si PBA (Primeary Butterfly Area). Për shkak të pasurisë së madhe me shpendë, si dhe kalimit të rrugëve migratore nëpër zonë, Bjeshkët e Nemuna janë konstatuar edhe si IBA rajone (IBA- Important Bird Areas)

4.2 Klima dhe Temperatura

Klima - e komunës së Pejës është e mesme - kontinentale me ndikim të asaj mesdhetare që depërton nëpër luginën e Drinit të Bardhë. Klima malore e regjionit të Rugovës karakterizohet me verën e nxehtë e dimrin e ftohtë dhe të gjatë. Temperatura mesatare shumëvjeçare vjetore është 11.6°C. Temperatura mesatare shumëvjeçare e korrikut është 21.7°C , ndërsa e janarit - 0,5°C. Temperatura më e ulët e regjistruar është -23°C në dhjetor, dhe më e larta 35°C në gusht.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Zgjerimin e zonës së Shfrytëzimit

Të dhënat klimatologjike (m/s): 2020

Gjatësia gjeografike e st.: 20° 18' 18.30"

Lartësia mbidetare e st.: 498 m lmd

Gjerësia gjeografike e st.: 42° 39' 56.30"

Muaji	Temperaturat (°C)				Temperatura extreme (°C)						Shtypja e ajrit (hPa)	
	7	14	21	Tmes	Tmin	Tmax	Min	Dita	Max	Dita	Mes	
I	-1.0	3.3	-0.4	0.4	-2.8	3.7	-7.6	18/01	11.2	25/01	965.0	
II	3.1	9.7	4.0	5.2	1.1	9.9	-6.4	07/02	17.9	26/02	959.2	
III	4.9	11.6	5.9	7.1	3.1	11.9	-1.6	23/03	21.7	13/03	955.0	
IV	7.6	16.0	9.4	10.6	5.0	16.9	-2.4	01/04	26.0	19/04	954.5	
V	11.9	20.6	13.7	15.0	9.1	21.7	4.9	06/05	33.8	15/05	956.6	
VI	14.4	23.3	15.9	17.4	11.6	24.3	8.6	04/06	31.8	30/06	952.8	
VII	19.5	28.1	21.7	22.8	16.2	29.2	13.4	18/07	33.9	02/07	954.9	
VIII	19.0	26.3	22.5	22.6	17.1	27.9	12.6	06/08	31.8	31/08	955.5	
IX	16.2	23.8	20.4	20.2	13.9	24.9	7.6	27/09	29.6	13/09	957.9	
X	10.1	16.2	13.0	13.1	8.4	17.0	3.8	20/10	27.3	05/10	956.5	
XI	5.1	10.7	7.1	7.5	4.1	11.3	-3.1	27/11	20.4	04/11	965.1	
XII	2.5	6.1	4.4	4.3	1.7	6.4	-6.3	02/12	13.4	25/12	955.8	
Viti	9.4	16.3	11.5	12.2	7.4	17.1	-7.6	18/01	33.9	02/07	957.4	

Muaji	Lagështia e ajrit (%)				RD (h)	Mbulueshmëria me re (0-10)				Reshje shiu (mm)			Bora (cm)	
	7	14	21	Mes	Σ	7	14	21	Mes	Σ	Max	Dita	Tot	Ere
I	93	69	90	84	-	5.8	6.2	6.2	6.1	11.2	10.6	27/01	-	-
II	91	52	86	76	-	5.1	5.1	5.7	5.3	19.7	5.8	05/02	-	-
III	93	61	88	80	-	7.2	6.5	7.7	7.1	68.2	21.4	07/03	-	-
IV	94	56	90	80	-	5.7	5.6	6.3	5.8	49.8	28.0	22/04	-	-
V	93	57	86	79	-	7.5	7.7	7.6	7.6	74.8	24.5	21/05	-	-
VI	93	54	86	78	-	6.7	7.1	7.0	6.9	46.2	13.5	21/06	-	-
VII	84	51	79	71	-	6.0	5.5	6.9	6.1	46.0	23.9	27/07	-	-
VIII	77	53	63	64	-	6.6	6.4	6.7	6.6	99.7	17.4	01/08	-	-
IX	74	49	61	61	-	6.5	5.9	6.1	6.2	100.0	35.5	26/09	-	-
X	87	66	77	77	-	6.5	5.4	6.3	6.1	212.4	86.0	05/10	-	-
XI	84	66	79	76	-	5.3	5.3	5.5	5.4	0.0	0.0	01/11+	-	-
XII	93	82	90	88	-	8.9	8.8	9.2	9.0	226.2	68.5	31/12	-	-
Viti	88	60	81	76	-	6.5	6.3	6.8	6.5	954.2	86.0	05/10	-	-

Muaji	Ditë me													
	Temperaturat (°C)						Shpejtësia e erës (m/s)		Mbulueshmëria me re (0-10)		Reshje shiu (mm)			
	Tn ≤ -10	Tn < 0	Tn ≥ 20	Tx < 0	Tx ≥ 25	Tx ≥ 30	> 6	> 8	< 2	> 8	≥ 0.1	≥ 1	≥ 10	
I	0	24	0	6	0	0	0	0	0	11	2	1	1	
II	0	7	0	0	0	0	2	2	2	8	8	6	0	
III	0	4	0	0	0	0	1	0	2	15	10	10	2	
IV	0	2	0	0	2	0	0	0	6	8	9	8	1	
V	0	0	0	0	11	3	1	0	0	13	13	11	3	
VI	0	0	0	0	13	1	1	1	0	7	13	9	1	
VII	0	0	0	0	27	15	1	0	1	7	8	7	1	
VIII	0	0	2	0	28	7	1	1	1	10	13	12	4	
IX	0	0	0	0	16	0	0	0	6	13	7	7	4	
X	0	0	0	0	1	0	0	0	1	7	7	7	5	
XI	0	4	0	1	0	0	0	0	3	9	0	0	0	
XII	0	10	0	0	0	0	0	0	0	24	9	8	7	
Viti	0	51	2	7	98	26	7	4	22	132	99	86	29	

Figura 6. Të Dhënat Klimatologjike për Rajonin e Pejës

4.3 Karakteristikat Hidrografike

Hidrografia - Rrafshi i Dukagjinit konsiderohet si treva më e pasur në Kosovë me resurse ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Komuna e Pejës ka një rrjet të zhvilluar hidrografik si lumenj, përroska, puse, liqene, burime. Duke marrë parasysh që ato mbushen nga reshjet e shiut dhe borës, sasia më e madhe e rrjedhave ujore është në vjeshtën e vonë dhe në pranverë.



Figura 7. Rrjeti Hidrografik i komunës së Pejës

Lumbardhi i Pejës buron në Bjeshkët e Nemuna në më se 1.900 metra lartësi mbidetare. Në rrjedhën e vet të epërme, në Grykën e Rugovës ai është lum malor me një numër të madh kaskadash dhe rrymash të shpejta. Në rrjedhën e tij të poshtme, në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit, Lumbardhi rrjedh qetë duke krijuar shtratin e vet, i cili në disa vende arrin gjerësi deri në 200 m, dhe në Grabanicë derdhet në Drinin e Bardhë. Lumbardhi mbledh disa burime përgjatë Grykës së Rugovës si: Lumin e Boges në anën e majtë të tij dhe Lumin e Allagës në derdhjen e së cilit në Lumbardh ka kushte për ndërtimin e një akumulacioni relativisht të madh të ujit. Sipërfaqja ujëmbledhëse e Lumbardhit të Pejës është 464.8 km², me një gjatësi prej 57km, ndërsa prurja mesatare e ujit është 10,22 m³/sek.

Drini i Bardhë është një nga lumenjtë më të mëdhenj, dhe ujëmbledhësi kryesor hidrografik i rrafshit të Dukagjinit, me sipërfaqe prej 4340 km², gjatësi prej 110.7 km dhe prurje mesatare të ujit 61.7 m³ /s. Buron afër fshatit Radave, rrëzë maleve të Zhlebit, në një lartësi mbidetare prej afër 580 metrash. Në dalje të burimit lumi krijon ujëvarë, e pastaj me zbritje relativisht të vogël, rrjedhë në një gjatësi prej afër 110 kilometrash deri në daljen e tij në Shqipëri.

Sipas Master Planit për Ujëra e Kosovës 1983-2000, potencialet më të mëdha të ujërave nëntokësore gjinden në rrafshin e Dukagjinit dhe shfrytëzimi i tyre bëhet kryesisht përmes puseve dhe burimeve të cilat edhe në Komunën e Pejës janë të shumtë.

Në zonën e Rugovës gjenden edhe liqenet glaciale si ai i Kuqishtës (1900 m), Liqeni i Drelajve (1800m), dhe 2 liqenet në Leqinat në lartësi prej 1860 m që shquhen për bukurinë e tyre dhe rrethinën e mbuluar me pyje të dendura pishe.

4.4 Lagështia Relative e Ajrit

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70,2%. Lagështia më e madhe mesatare e ajrit është në dhjetor, kurse më e vogla në qershor.

4.5 Vrantësimi dhe diellosja

Diellosja është e mirë, me një numër të mjaftueshëm ditësh me diell dhe 1958 orë në vit. Numri mesatar i ditëve të vrenjtura (75.9) dhe të kthjellëta (155. ditë) gjatë vitit është i volitshëm.

4.6 Të reshurat

Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë ndër më të mëdhatë në Kosovë. Mesatarja vjetore shumëvjeçare e të reshurave në pjesën kodrinore-fushore është rreth 800 mm, e në pjesën bregore-malore arrin mbi 1.025 mm. Pjesa më e madhe e këtyre reshjeve bie në dimër në formë bore, por edhe shiut.

4.7 Era

Erërat janë me shpejtësi të mesme 1.3 m/s, më të shpeshtat ato jug-perëndimore dhe perëndimore.

5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Zgjerimi i zonës së eksploatimit të materialeve inerte nga kompania “VRANINA” SH.P.K. mund të shoqërohet me ndikime të ndryshme mjedisore gjatë gjithë ciklit të zhvillimit të aktivitetit, që nga faza e përgatitjes së terrenit, faza e eksploatimit, e deri te faza e rehabilitimit pas përfundimit të shfrytëzimit. Intensiteti dhe shtrirja e këtyre ndikimeve varen nga faktorë të tillë si pozicioni gjeografik i zonës së projektit, karakteristikat fizike dhe natyrore të terrenit, si dhe mënyra e organizimit dhe menaxhimit të procesit të eksploatimit të rërës dhe zhavorrit. Në bazë të analizës së gjendjes ekzistuese në terren dhe karakteristikave të aktivitetit të planifikuar, në këtë kapitull paraqitet një vlerësim i detajuar i ndikimeve të mundshme në mjedis, së bashku me përcaktimin e masave zbutëse që do të aplikohen për parandalimin, eliminimin ose minimizimin e ndikimeve negative të mundshme. Qasja analitike synon të sigurojë që zgjerimi i zonës së eksploatimit të realizohet në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Analiza e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për këtë projekt është realizuar duke u bazuar në gjendjen faktike të zonës së eksploatimit të kompanisë “VRANINA” SH.P.K., si dhe në vlerësimin e ndikimeve potenciale në komponentët kryesorë të mjedisit. Vlerësimi përfshin ndikimet në cilësinë e ajrit, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokën dhe karakteristikat fiziko-kimike të mjedisit, si dhe aspektet biologjike dhe ekologjike, me theks të veçantë në ruajtjen e biodiversitetit dhe ekuilibrin natyror. Gjithashtu, në analizë janë trajtuar edhe aspektet socio-ekonomike, duke vlerësuar ndikimet e mundshme pozitive dhe negative, të përkohshme apo afatgjata, që aktiviteti i eksploatimit mund të ketë në zonën përreth. Qëllimi përfundimtar i këtij vlerësimi është që projekti të kontribuojë në zhvillimin ekonomik lokal, pa cenuar vlerat mjedisore dhe shëndetin e komunitetit.

5.1 Ndikimet në ajër

